V E N D I M
Nr. 291, datë 24.6.1999

PËR ANËTARËSIMIN E SHQIPËRISË NË FONDIN SOCIAL TË ZHVILLIMIT, TË KËSHILLIT TË EUROPËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 «Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare», me propozimin e Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Anëtarësimin e Shqipërisë në fondin Social të Zhvillimit, të Këshillit të Europës, duke marrë përsipër të gjitha detyrimet, financiare dhe politike, që rrjedhin nga ky anëtarësim.

2. Të pranojë shumën prej 1 860 538 (një milionë e tetëqindegjashtëdhjetë mijë e pesëqindetridhjetetetë) EUR-sh, dhuratë e Fondit Social të Zhvillimit, për pagimin e pjesëmarrjes së Shqipërisë në kapitalin dhe kontributin e rezervës së Fondit.

3. Ngarkohet ministri i Punëve të Jashtme të paraqesë pranë Këshillit të Europës Deklaratën e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, për anëtarësimin e Shqipërisë në Fondin Social të Zhvillimit, të Këshillit të Europës.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme të caktojë përfaqësuesin e vendit tonë në bordin drejtues dhe Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë të caktojë përfaqësuesin në Këshillin e Fondit Social të Zhvillimit.

5. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko